



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

Nr. 618 Prot.,

Tiranë, më 09. 12. 2022

RREGULLORE E QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

MIRATOI

KRYETARI

Eduart MAKRI



Kjo Rregullore hartohet në zbatim të:

1. Ligjit 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë", të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
2. Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike";
3. Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".

KAPITULLI I

DETYRAT KRYESORE TË QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

Detyrat kryesore të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (këtu e më poshtë Qendra), përfshihen, por nuk kufizohen si më poshtë:

I- FINANCIMI I PROJEKTEVE KINEMATOGRAFIKE:

1- Financimi i projekteve kinematografike për zhvillim projekti.

2- Financimi i projekteve kinematografike, për prodhimin e filmave në kategoritë:

- a. Projekte për filma artistikë me metrazh të gjatë, vepër karriere.
- b. Projekte për filma artistikë me metrazh të gjatë- vepër e parë.
- c. Projekte për filma artistikë me metrazh të shkurtër.
- d. Projekte për filma dokumentarë.
- e. Projekte për filma të animuar.

3- Financimi i projekteve për bashkëprodhim në minorancë (minority co-production).

4- Financimi i projekteve për promovim të kinematografisë shqiptare:

- a. Projekte për promovimin brenda dhe jashtë vendit të filmave (që administrohen, apo janë prodhuar me financimin e Qendrës).
- b. Projekte për pjesëmarrje në festivale filmi (kombëtare apo ndërkombëtare), si dhe organizimi i pavioneve promovuese në festivale ndërkombëtare të filmit.
- c. Projekte për organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare (brenda dhe jashtë vendit) me institucione simotra, apo organizma të industrisë së prodhimit kinematografik, si dhe aktivitete për bashkëpunime me institucionet simotra dhe organizma të tjera kulturore, aktivitete kombëtare apo ndërkombëtare të filmit.

5. Financimi i projekteve për festivale filmi (kombëtare dhe ndërkombëtare).

6. Financimi i projekteve të ndryshme kinematografike:

- a. Projekte për javë filmi (kombëtare dhe ndërkombëtare).
- b. Projekte kinematografike për kualifikimin, specializimin, përgatitjen e kineastëve të rinj dhe stafit të Qendrës (seminare, workshop-e, apo dhe aktivitete të tjera kinematografike).
- c. Projekte të ndryshme kinematografike për botime kinematografike, apo evente të ndryshme për nder të kineastëve të shquar shqiptarë.

II- Detyrat administrative dhe organizative të Qendrës janë si më poshtë:

- a. Administron fondin buxhetor për mbështetjen financiare të projekteve kinematografike, të cilët shpallen fitues nga Këshilli i Miratimit të Projekteve.
- b. Administron gjithë procesin dhe akordon mbështetjen financiare për projektet kinematografike që përmbushin kërkesat e kësaj Rregulloreje.
- c. Raporton për realizimin e projekteve dhe realizimin e planit të buxhetit në institucionet përkatëse.
- d. Regjistron personat fizikë e juridikë (përveç personave juridikë publikë, apo subjektet që gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre nuk kanë qëllim fitimprurës), që merren me prodhimin, shpërndarjen dhe shfaqjen e filmit, duke i pajisur me lejen përkatëse kundrejt pagesës së regjistrimit. Pagesa e regjistrimit përcaktohet me akte nënligjore.
- e. Vizionon dhe pajis me leje qarkullimi veprat filmike të realizuara brenda vendit, ose të importuar, që shfaqen në salla apo media elektronike, në territorin e RSh. Këtë detyrë ajo e përmbush nëpërmjet funksionimit të Komisionit të Vizionimit, i cili bën klasifikimin e filmit në përputhje me ligjin, dhe kryen procedurat e nevojshme për pajisjen e filmit me leje qarkullimi në territorin e RSh.
- f. Përgatit kërkesa për leje xhirimi për produksionet vendase dhe të huaja që xhirojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- g. Kontrollon zbatimin e standarteve teknike të aparaturave që funksionojnë për prodhimin dhe shfaqjen e veprave filmike nëpërmjet strukturës apo personave të autorizuar prej saj.
- h. Organizon dhe mbështet financiarisht kualifikimin dhe përgatitjen e kineastëve të rinj, duke koordinuar punën me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Ministrinë e Kulturës, institucionet arsimore dhe kulturore përkatëse brenda dhe jashtë vendit, si dhe fondacione kombëtare apo ndërkombëtare, që japin ndihmën e tyre në fushën e artit dhe kulturës.
- i. Informon producentët për mundësitë financiare të Qendrës, ndryshimet në Këshillat Miratues të Projektve, aktet ligjore dhe nënligjore, festivalet apo javët e filmit kombëtare e ndërkombëtare, si dhe për seminare e simpoziume që organizohen prej saj.

KAPITULLI II

FONDET DHE TË ARDHURAT E QENDRËS

- Qendra, administron fonde publike, të përcaktuara me zë më vete në buxhetin e shtetit.
- Të ardhurat e Qendrës përbëhen nga:
 1. Të ardhurat nga shitja, distribucioni dhe shfaqja e veprave filmike, të prodhuara me financim të Qendrës.
 2. Të ardhurat që realizohen nga administrimi i prodhimit kinematografik të Kinostudios “Shqipëria e Re” deri në vitin 1990.
 3. 1% e të ardhurave të realizuara nga shitja e biletave në kinema.
 4. Tarifat e regjistrimit të producentëve, distributorëve, si dhe ato për kategorizimin dhe liçensimin e filmave që qarkullojnë në territorin e vendit.
 5. Të ardhura të tjera nga sponsorë e donatorë.

KAPITULLI III

STRUKTURA ORGANIZATIVE E

QENDRËS

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave datë 21.06.2006, nr. 407, “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve të disa institucioneve në varësi të ministrave të linjës” dhe urdhrit të Kryeministrit nr. 5, datë 18.01.2012, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”, të ndryshuar me Urdhërin e Kryeministrit, nr. 132, datë 28.03.2014; struktura organizative e Qendrës është:

I. Kryetari

II. Drejtoria e Projekteve

1. Drejtori i Drejtorisë së Projekteve
2. Specialist Jurist
3. Specialist për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Shtypin
4. Specialist për Projektet
5. Arshivist

III. Sektori i Shërbimeve të Brendshme

1. Përgjegjës sektori i Financës dhe Shërbimeve
2. Specialist, Inspektor për Projektet, Menaxher
3. Specialist Shërbimi

KAPITULLI IV

KËSHILLAT DHE KOMISIONET

Pranë Qendrës funksionojnë këto këshilla dhe komisione:

- I. Këshillat e Miratimit të Projekteve.
- II. Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve.
- III. Komisioni i Monitorimit të Projekteve kinematografike.
- IV. Komisioni Financiar.
- V. Komisioni i Vizionimit.

I. KËSHILLAT E MIRATIMIT TË PROJEKTEVE

1. Këshillat Miratues të Projekteve (KMP), janë organizma kolegjiale jashtë strukturës administrative të Qendrës.
2. KMP ndihmojnë aktivitetin e Qendrës me ekspertizën e tyre për vlerësimin e projekteve kinematografike.
3. KMP ka mandat ligjor 2- vjeçar. Veprimtaria e tyre shpërblehet me honorar, sipas përcaktimit të bërë në aktet nënligjore në fuqi.
4. KMP e filmit artistik dhe dokumentar do të shqyrtojë edhe projektet e filmit të animuar, në rast se nuk arrihet të formohet KMP e filmit të animuar.

A. KRITERET PËR ANËTARËT E KMP:

“A. KRITERET PËR KANDIDATURAT PËR ANËTARË TË KMP DHE PËBËRJA E TIJ:

1. Këshilli i Miratimit të Projekteve do të përbëhet nga:
 - a- 3 (tre) anëtarë/anëtare me shtetësi të huaj, të cilët duhet të plotësojnë këto kritere:
 - 1 (një) anëtar/anëtare i cili të jetë Regjisor, Producent;
 - 2 (dy) anëtarë/anëtare, të cilët duhet të jenë Skenaristë.
 - b- 2 (dy) anëtarë/anëtare me shtetësi shqiptare, të cilët duhet të plotësojnë këto kritere:
 - 1 (një) anëtar/anëtare të jetë Regjisor;
 - 1 anëtar/anëtare të jetë Producent, ose Skenarist.
2. Anëtarët e KMP duhet të jenë personalitete të fushës së artit dhe kulturës, vendas dhe të huaj, të cilët janë vlerësuar për kontributin e tyre në kinematografi dhe që plotësojnë këto kritere:

- a- Të kenë realizuar jo më pak se tre filma artistikë, nga të cilët një të jetë pranuar në konkurim zyrtar në një festival kompetitiv (kategoria A);
 - b- Të mos kenë precedentë penalë;
 - c- Të kenë figurë të pastër etike.
3. Personat që vlerësojnë se plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, si dhe kanë dëshirë të kandidojnë për të dhënë kontributin e tyre si anëtar i KMP, kanë të drejtë të aplikojnë nëpërmjet shprehjes së interesit në platformën e aplikimit që Qendrës do të bëjë publike në faqen zyrtare, si dhe do ta promovojë dhe shpërndajë në rrjetet sociale.
 4. Pas përfundimit të afatit të shprehjes së interesit për kandidim në KMP, Kryetari i Qendrës përzgjedh listën e kandidatëve që do t'i nënshtrohet procesit të votimit.
 5. Lista do të përbëhet nga 6 (gjashtë) kandidatura, shtetas të huaj dhe 4 (katër) kandidatura shtetas shqiptarë.
 6. Kriteret e përcaktuara në pikën 2 do të respektohen sa më shumë të jetë e mundur, në rast se konstatohet pamundësi për plotësimin e tyre nga kandidaturat që do të ofrohen.

B. PARIME TË PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E KINEASTËVE QË KANË TË DREJTË VOTIMI:

1. Këshilli i Miratimit të Projekteve me mandat ligjor (Shtator 2021-Shtator 2023), do të përzgjidhet sipas parimit “një anëtar-një votë”.
2. Të drejtën e votimit në procesin e përzgjedhjes së Këshillit të Miratimit të Projekteve me mandat ligjor (Shtator 2021-Shtator 2023) e kanë shtetasit shqiptarë që kanë kredite në filmat e metrazhit të gjatë të financuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë (këtu e më poshtë votuesi kineast) si vijon:
 - a. Skenarist;
 - b. Regjisor;
 - c. Producent. (si i tillë do të konsiderohet vetëm administratori i shtëpisë kinematografike që ka marrë përsipër realizimin e filmit në kohën që është realizuar).
3. Të drejtën e votimit në procesin e përzgjedhjes së Këshillit të Miratimit të Projekteve me mandat ligjor (Shtator 2021-Shtator 2023) e kanë shtetasit shqiptarë që kanë kredite Regjisor në filmat e animuar të financuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.

C. PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË VOTUESVE KINEASTË:

1. Qendra Kombëtare e Kinematografisë hap procesin e regjistrimit për votuesit kineastë, që vlerësojnë se kanë të drejtë për të votuar. Regjistrimi bëhet në mënyrë vullnetare nga personat që e gëzojnë këtë të drejtë sipas përcaktimit të bërë në nënpikën B. Personat që nuk e

ushtrojnë të drejtën e regjistrimit në mënyrë vullnetare brenda afatit të përcaktuar, e humbasin të drejtën e votimit për zgjedhjen e KMP me mandat ligjor (Shtator 2021-Shtator 2023).

2. Qendra vë në dispozicion një sistem regjistrimi elektronik, i cili garanton të drejtën për të deklaruar kreditet personale në filmat e realizuar. Sistemi i aplikimit promovohet dhe shpërndahet në faqen zyrtare të Qendrës, si dhe në të gjitha rrjetet sociale.
3. Pas përfundimit të afatit të regjistrimit, i cili do jetë jo më pak se 30 ditë pune, stafi i Qendrës bën verifikimet përkatëse dhe bazuar në informacionet dhe statistikat institucionale pranon, ose refuzon regjistrimin e bërë.
4. Njoftimi për pranimin, apo refuzimin e regjistrimit i bëhet individualisht aplikuesit, në rrugë elektronike, duke dhënë edhe argumentat përkatës.
5. Kur regjistrimi i kryer rezulton korrekt dhe miratohet, kineastit i lind e drejta të marrë pjesë në votim për zgjedhjen e KMP.”.

D. PROCEDURA E KRYERJES SË VOTIMIT DHE ZGJEDHJES SË KMP:

1. Në platformën e votimit të garantuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë secili votues kineast që ka kryer procedurën e regjistrimit vullnetar dhe i është njohur e drejta e votimit, pasi pajiset me kredencialet elektronike, ka të drejtë të shprehet nëpërmjet votës për përbërjen e KMP.
2. Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka detyrimin të promovojë dhe njoftojë në faqen zyrtare të internetit, si dhe në rrjetet sociale afatin dhe mënyrën e votimit.
3. Procesi i votimit duhet të zgjasë të paktën 15 ditë kalendarike.
4. Secili votues ka të drejtë të shprehë vullnetin e tij për përbërjen e KMP. Në këtë kuptim secili votues kineast ka të drejtë të votojë për 5 (pesë) anëtarët që personalisht preferon të jenë në KMP, sipas përbërjes së përcaktuar 3 anëtarë me shtetësi të huaj dhe 2 anëtarë me shtetësi shqiptare.
5. Votat që nuk kanë respektuar raportin e anëtarëve sipas shtetësisë, do të quhen të pavlefshme.
6. Votimi individual është i sekretuar dhe për asnjë arsye nuk mund të bëhet publik, apo t’u jepet personave të tretë.
7. Kredencialet e administrimit të sistemit të votimit mbahen nga Kryetari i Qendrës, Juristi dhe Specialisti i Shërbimeve të Qendrës.
8. Pas mbylljes së afatit të votimit, Qendra Kombëtare e Kinematografisë administron dhe analizon rezultatet e votimit, të cilat i bën publike jo më vonë se 5 ditë pune.
9. Për evidentimin e rezultateve të votimit Qendra Kombëtare e Kinematografisë ngre një grup të përkoshëm pune me 5 anëtarë:
 - a. Kryetari;
 - b. Drejtori i Drejtorisë së Projekteve;

- c. Juristi;
 - d. Përgjegjës Sektori;
 - e. Specialist mbështetës – IT.
10. Për evidentimin e rezultateve të votimit grupi i përkohshëm i punës harton një raport me shkrim në të cilin jepet informacion lidhur me:
 - a. Numrin e pjesëmarrësve në votim;
 - b. Numrin e votave të vlefshme;
 - c. Numrin e votave të pavlefshme;
 - d. Renditjen me pikë për secilin kandidat për anëtar të KMP.
 11. Në Këshillin e Miratimit të Projekteve do të emërohen tre kandidatët me shtetësi të huaj, si dhe dy kandidatët me shtetësi shqiptare që kanë marrë më shumë pikë nga votimi i përgjithshëm.
 12. Në përfundim të procesit, Kryetari i Qendrës miraton aktin administrativ për përbërjen e Këshillit të Miratimit të Projekteve me mandat ligjor Shtator 2021-Shtator 2023.”.

E. FUNKSIONIMI I KMP:

1. Detyra kryesore e anëtarëve të KMP është vlerësimi i projekteve kinematografike nga pikëpamja artistike dhe ekonomike. Anëtarët e KMP mbajnë përgjegjësi administrative për çdo vendim që marrin.
2. Mbledhjet e KMP kryhen me prezencë fizike në Qendër, ose mbledhje on line.
3. Anëtarët e KMP, në mbledhjen e parë me prezencë fizike kryejnë këto procedura:
 - a. zgjedhin Kryetarin e KMP me votim të hapur;
 - b. plotësojnë dhe nënshkruajnë:
 - deklaratën për konfliktin e interesit;
 - formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
4. Kryetari i KMP, kur mbledhjet kryhen me prezencë fizike drejton mbledhjen, garanton zbatimin e ligjshmërisë, zbatimin e rregullave të etikës në komunikim ndërmjet pjesëmarrësve në mbledhje, si dhe marrjen e vendimeve të drejta konform legjislacionit në fuqi.
5. Mbledhjet e KMP organizohen nga Qendra, si rregull 15 ditë pas dërgimit të projekteve tek anëtarët e KMP.
6. Kryetari i Qendrës, përcakton datën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjeve.
7. Mbledhjet e KMP, janë të vlefshme kur janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve.
8. KMP vlerëson me përparësi projektet që:
 - kanë bashkëprodhime reale,
 - garantuar financime alternative,
 - garantojnë marrëdhënie premtuese bashkëpunimi me subjekte të tjerë, vendas apo të huaj.

9. KMP miraton projektet fituese me votim me pikë, sipas fletëve të votimit, të cilat miratohen me vendim të posaçëm të Kryetarit të Qendrës.
10. Në vlerësimin e punës së mëparshme të regjisorit do t'i jepet prioritet dhe vlerësim me pikë filmave që janë kualifikuar në konkurim zyrtar (main competition) në festivalet e akredituara dhe të njohura nga Qendra si më poshtë:

- ✓ *Berlin International Film Festival*
- ✓ *Cannes Film Festival*
- ✓ *Karlovy Vary International Film Festival*
- ✓ *Locarno International Film Festival*
- ✓ *International Film Festival Rotterdam*
- ✓ *Mar del Plata International Film Festival*
- ✓ *San Sebastian International Film Festival*
- ✓ *Shanghai International Film Festival*
- ✓ *Sundance Film Festival*
- ✓ *Telluride Film Festival*
- ✓ *Tokyo International Film Festival*
- ✓ *Toronto International Film Festival*
- ✓ *Tribeca Film Festival*
- ✓ *Venice International Film Festival*
- ✓ *Warsaw International Film Festival*
- ✓ *Tallinn Black Nights International Film Festival*
- ✓ *Montreal World Film Festival*
- ✓ *Cairo International Film Festival*
- ✓ *International Film Festival of India (Goa)*
- ✓ *HotDocs Canadian International Documentary Film Festival*
- ✓ *International Documentary Film Festival Amsterdam (IDFA)*
- ✓ *Annecy Animation Film Festival*
- ✓ *Palm Springs International Festival of Short Films*
- ✓ *Oberhausen Short Film Festival*
- ✓ *Clermont Ferrand Short Film Festival*
- ✓ *Tampere Short Film Festival*
- ✓ *Istanbul International Film Festival*
- ✓ *Brussels International Film Festival*
- ✓ *Sarajevo International Film Festival*
- ✓ *Sofia International Film Festival*
- ✓ *Thessaloniki International Film Festival*
- ✓ *Nemur International Film Festival*
- ✓ *Bussan International Film Festival*
- ✓ *Antalya International Film Festival*
- ✓ *Sydney International Film Festival*
- ✓ *Bilbao International Short and Documentary Film Festival*
- ✓ *Leipzig Documentary Film Festival*
- ✓ *Copenhagen Documentary Film Festival*
- ✓ *Thessaloniki Documentary Film Festival*
- ✓ *Rome International Film Festival RIFF*
- ✓ *FILMFEST MÜNCHEN*

11. Në vlerësimin e projekteve do t'i jepet prioritet dhe vlerësim me pikë projekteve filmike që kanë realizuar paraprakisht zhvillimin e projektit, duke marrë mbështetje financiare, apo duke u kualifikuar në ente të specializuara për këtë qëllim të njohura nga Qendra si më poshtë:

- ✓ *Creative Europe - Media Program (script development fund)*
- ✓ *eQuinoxe Europe International Screenwriters` Workshops*
- ✓ *FIRST FILMS FIRST*
- ✓ *LIM | Less is More*
- ✓ *MFI Script2Film - Mediterranean Film Institute*
- ✓ *MIDPOINT Institute*
- ✓ *Script Station | Berlinale Talents*
- ✓ *ScripTeast - Independent Film Foundation (Eastern Europe countries)*
- ✓ *ScriptLab | TorinoFilmLab*
- ✓ *Talents Labs | Berlinale Talents*
- ✓ *The Residence - Cinéfondation*
- ✓ *WHEN EAST MEETS WEST – Trieste*
- ✓ *Cinekid Script LAB:*

12. Anëtari i KMP, individualisht, plotëson fletën e votimit, duke shprehur vlerësimin me pikë dhe konkluzionet për secilin projekt, duke nënshkruar çdo fletë votimi.
13. KMP rendit projektet nga projekti me vlerësimin maksimal, e deri te projekti me vlerësim minimal.
14. Juristi i Qendrës është prezent në këtë procedurë dhe çertifikon procesin e votimit.
15. KMP shprehet për vlerësimin financiar të projekteve, bazuar në ekspertizën e bërë nga Komisioni Financiar, i cili bën përlllogaritjet në bazë të tarifave të financimit, të miratuara nga Kryetari i Qendrës.
16. Anëtari i KMP nënshkruan vendimin përfundimtar të mbledhjes në gjuhën shqipe dhe angleze.

F. TË DREJTAT E ANËTARIT TË KMP:

Anëtari i KMP gëzon këto të drejta gjatë ushtrimit të mandatit:

1. Merr njoftim të rregullt për detajet si: data, vendi, si dhe rendi i ditës së mbledhjes që do të zhvillohet.
2. Shpreh mendimin e tij për çështjet që shtrohen për diskutim.
3. Shprehet me votim me pikë për projektet që shqyrtohen, në pavarësi të plotë dhe me integritet profesional.
4. Disponon materialet e projekteve që shqyrtohen, të paktën 15 ditë nga data e zhvillimit të mbledhjes.
5. Paguhet për pjesëmarrjen në mbledhje (kur mbledhja përfundon me një vendim efektiv, që nënkupton shpalljen e projekteve fituese), sipas akteve

nënligjore në fuqi, në varësi të llojit të projekteve që shqyrtohen.

G. DETYRAT E ANËTARIT TË KMP:

Anëtari i KMP ka këto detyrime gjatë ushtrimit të mandatit:

1. Merr pjesë rregullisht në mbledhjet e KMP.
2. Respekton rregullat e etikës në komunikim gjatë mbledhjeve të KMP.
3. Dëshmon integritet dhe profesionalizëm në vendimmarrje.
4. Paraqet argumentim të shkurtër për secilin komponent të vlerësimit me pikë, për çdo projekt.
5. Nënshkruan në përgjegjësi të plotë deklaratën për konfliktin e interesit dhe të njoftojë me shkrim Kryetarin e Qendrës, në rast se evidenton apo konstaton se vendimmarrja e tij përbën konflikt interesi.
6. Lexon dhe njeh në mënyrë të detajuar skenarët dhe dokumentacionin shoqërues të secilit projekt konkurrues.
7. Sheh filmin/at paraardhës të regjisorit dhe të producentit aplikues, (për këtë qëllim në dokumentacionin e çdo projekti do të gjeni link të filmit online, të shoqëruar me password).
8. Nuk ka të drejtë të aplikojë, ose të jetë pjesë e projekteve konkurruese gjatë periudhës kohore 2 (dy) vjeçare të ushtrimit të mandatit si anëtar i KMP-së. Ky përcaktim është i vlefshëm edhe në rastin kur anëtari i KMP- së jep dorëheqjen e parakohshme nga mandati i tij.
9. Në rastin e dorëheqjes së parakohshme të një anëtari të KMP, anëtari zëvendësues i nënshtrohet këtij rregulli për periudhën kohore kur fillon detyrën si anëtar i KMP, e deri në përfundim të mandatit të KMP.
10. Në rast se verifikohet marrja e vendimeve në kushtet e konfliktit të interesit, Qendra është e detyruar që të veprojë sipas përcaktimeve ligjore të parashikuara për këto raste.

H. PËRFUNDIMI I PARAKOHSHËM I MANDATIT:

Anëtari i KMP, largohet nga ky funksion përpara përfundimit të mandatit në rastet kur:

1. Jep dorëheqje me shkrim;
2. Bëhet i paaftë për arsye shëndetësore;
3. Vërtetohet se ka marrë vendim, në konflikt interesi me projekte të shqyrtuara;
4. Kryen veprime që janë në kundërshtim me etikën e komunikimit, të cilat pengojnë mbarëvajtjen dhe zhvillimin normal të mbledhjeve të KMP;
5. Dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

II. KOMISIONI I SHQYRTIMIT PARAPRAK TË PROJEKTEVE

1. Komisioni i Shqyrtimit Paraparak të Projekteve, përbëhet nga:
 - ✓ Kryetari;
 - ✓ Drejtori i Drejtorisë së Projekteve;
 - ✓ Juristi.

2. Komisioni ka detyrë kryesore shqyrtimin dhe seleksionimin e projekteve kinematografike që depozitohen dhe paraqitja e tyre në Këshillat Miratues të Projekteve. Komisioni e zhvillon punën e tij mbështetur në këtë procedurë:
 - a. Projektet e paraqitura për konkurim on line shkarkohen brenda 10 ditë pune nga data e përfundimit të afatit të përcaktuar për depozitimin e projekteve.
 - b. Dokumentacioni i paraqitur verifikohet nëse është i plotë.
 - c. Komisioni harton procesverbal për projektet e depozituara, në të cilin përcaktohen:
 - ✓ Gjithë projektet e depozituara për secilën kategori.
 - ✓ Projektet që skualifikohen për shkak të mangësisë në dokumentacion, apo mosplotësimit të kriterëve të vendosura për konkurim në kategoritë përkatëse (në rast se ka).
 - ✓ Projektet që kualifikohen për konkurim.
 - ✓ Pas nënshkrimit të procesverbalit, Komisioni i bën me dije secilit aplikues vendimin e Komisionit.

III. KOMISIONI I MONITORIMIT TË PROJEKTEVE KINEMATOGRAFIKE.

1. Komisioni i monitorimit të projekteve kinematografike, përbëhet nga:
 - ✓ Drejtori i Drejtorisë së Projekteve;
 - ✓ Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme;
 - ✓ Juristi.
2. Komisioni ka detyrë kryesore monitorimin e projektit në të gjitha fazat deri në përfundimin e tij, nga ana financiare dhe e dokumentacionit, me qëllim mirëadministrimin e fondeve publike që i akordohen produksioneve për realizimin e projekteve filmike.
3. Çdo anëtar i komisionit ka detyrë të inspektojë/monitorojë dhe asistojë produksionet (sipas kompetencave/detyrës që ushtron), me qëllim mirëadministrimin e fondeve publike dhe realizimit me sukses të projekteve kinematografike.
4. Komisioni, brenda hapësirave që lejon sipërmarrja e lirë e tregut të punës (kërkesë-ofertë), monitoron veçanërisht trajtimin e punonjësve të stafëve të filmit, kryesisht lidhur me garantimin e kushteve normale të punës, nga ana e producentëve.
5. Në përfundim të çdo projekti kinematografik, komisioni monitoron dhe përpilon raportin narrativ, duke evidentuar ecurinë e projektit, si dhe problematikat e realizimit të tyre, (në rast se vërehen).
6. Komisioni i raporton me shkrim Kryetarit të Qendrës, kur konstaton keqadministrim, shpërdorim, apo abuzim me fondet e akorduara dhe propozon masa administrative konkrete ndaj abuzuesit.
7. Kryetari, pas miratimit të raportit, në varësi të shkeljes së konstatuar, mund ta përcjellë atë për konsultim, apo vendimmarrje në KMP.

III. KOMISIONI FINANCIAR

1. Komisioni Financiar, është organizëm jo funksional, me mandat 1 vjeçar, i cili emërohet nga Kryetari i Qendrës dhe përbëhet nga tre anëtarë:
 - ✓ Përfaqësues i Qendrës;
 - ✓ Përfaqësues i Qendrës;
 - ✓ Përfaqësues i Drejtorisë Ekonomike të Ministrisë së Kulturës.
2. Komisioni Financiar ka këto kompetenca kryesore:
 - a. Vlerëson nga ana financiare projektet e paraqitura në konkurim, bazuar në normativat e brendshme, të miratuara konform procedurave të Qendrës, në zbatim të limiteve maksimale të financimit për çdo projekt kinematografik, që miratohen nga Kryetari i Qendrës.
 - b. ii. Miraton kërkesën për ndryshim zërash në preventivin e miratuar nga KF të projekteve kinematografike. Kërkesa e shtëpisë kinematografike duhet të jetë e argumentuar dhe e justifikuar. Komisioni ka të drejtë të mos e miratojë, në rast se kërkojnë ndryshime të cilat në buxhetin përfundimtar janë deklaruar se mbulohen nga bashkëprodhuesi.
 - c. Mbikqyr dokumentacionin financiar të shpenzimeve të bëra për fondin buxhetor të projekteve të financuara, si dhe afatet e parashikuara në kontratën e financimit.
 - d. Merr vendim për njohjen ose jo të shpenzimeve të kryera prej shtëpive kinematografike.
 - e. Aprovon situacionin përfundimtar të realizimit të projektit.
3. Kryetari i Qendrës ka të drejtë të kërkojë të miratojë situacionin përfundimtar të realizimit të projektit.
4. Mbledhjet e Komisionit Financiar evidentohen në një procesverbal, i cili hartohet në tre kopje.

IV. KOMISIONI I VIZIONIMIT

1. Komisioni i Vizionimit është organizëm jo funksional, me afat 2- vjeçar dhe përbëhet nga tre anëtarë:
 - ✓ Përfaqësues i Ministrisë së Kulturës;
 - ✓ Përfaqësues i Qendrës;
 - ✓ Përfaqësues i kineastëve.
2. Kryetari i Komisionit të Vizionimit zgjidhet nga anëtarët e komisionit.
3. Komisioni i Vizionimit pajis me Leje Qarkullimi veprat filmike, që paraqiten nga distributori për t'u pajisur me Leje Qarkullimi. Komisioni i Vizionimit mblidhet sa herë është e nevojshme.
4. Distributori i paraqet Komisionit të Vizionimit këto dokumente:
 - a. kërkesën për të kategorizuar dhe qarkulluar filmin.
 - b. kopjen e filmit (të përkthyer), në format DVD, apo në çdo suport tjetër në formë elektronike, list-dialogun në gjuhën shqipe.
 - c. Kopja e filmit e paraqitur duhet të jetë duhet të jetë e njëjtë me variantin që do të distribuohet.
 - d. Përveç filmave të prodhuar me financim të Qendrës, për të gjithë filmat

- e tjerë distributori duhet të paguajë tarifën e vizionimit, e cila është e përcaktuar me udhëzim të Ministrisë së Financave.
5. Vizionimi i filmit, duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga paraqitja e dokumenteve, e koordinuar me datën e caktuar nga distributori për premierën e shfaqjes së filmit.
 6. Vendimi i komisionit është i vlefshëm kur në vizionim marrin pjesë jo më pak se dy anëtarë të tij. Vendimi i komisionit merret me shumicë votash. Komisioni voton vetëm “pro” dhe “kundër”.
 7. Kur vepra filmike e paraqitur nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi, Komisioni i Vizionimit, nuk i pajis distributorët me leje qarkullimi të filmit.
 8. Vendimet pozitive të Komisionit kategorizohen:
 - a. Kategoria **“A”**, kur filmi lejohet të shfaqet dhe mund të shikohet nga të gjitha moshat.
 - b. Në këtë kategori hyjnë filmat që forcojnë idealet e humanizmit dhe kanë karakter edukues, përfshirë dhe fëmijët.
 - c. Kategoria **“B”**, kur filmi lejohet të shfaqet dhe mund të shikohet vetëm nga shtetasit mbi 14 vjeç.
 - d. Në këtë kategori hyjnë filmat, të cilët nuk janë në kontradiktë me parimet dhe normat universale të moralit, por ka kuadro të veçanta me përmbajtje erotike ose dhune.
 - e. Kategoria **“C”**, kur filmi lejohet të shfaqet dhe mund të shikohet vetëm nga shtetasit mbi 18 vjeç.
 9. Për vendimin e Komisionit, distributori njoftohet me shkrim. Në rast se distributori nuk është dakort me vendimin e Komisionit, ai ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë.
 10. Komisioni i Vizionimit ka të drejtë të mos pajisë me licensë qarkullimi, të gjithë ata filma që bien ndesh me dispozitat ligjore të Republikës së Shqipërisë që kanë të bëjnë me:
 - a. cënim të nderit dhe prestigjit të historisë dhe të kombit shqiptar.
 - b. kanë përmbajtje apo nxitin ndjenja urrejtje, raciste, terrorizëm, etj.
 - c. kultivojnë ideologji fundamentaliste, etj.
 - d. që kanë përmbajtje të thellë pornografike.
 11. Vendimi i komisionit konfirmohet nga Kryetari i Qendrës, i cili mbi bazën e relatimit të bërë nga Komisioni i Vizionimit, nënshkruan Lejen e Qarkullimit të filmit, e cila përmban:
 - a. Numrin e lejes në regjistrin audiovizual të Qendrës.
 - b. Titullin e filmit në gjuhën shqipe.
 - c. Titullin e filmit në gjuhën origjinale të prodhimit.
 - d. Kategorinë e filmit.
 - e. Nënshkrimin e Kryetarit dhe vula e Qendrës.

KAPITULLI V

MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE KINEMATOGRAFIKE

Përzgjedhja e projekteve kinematografike nga KMP-të, kur mbledhja zhvillohet me prezencë fizike të anëtarëve në Qendër, si rregull kryhet në 4 faza:

1. Prezantimi i projektit nga aplikantët (pitching).

Projekti mund të prezantohet nga aplikantët para KMP-ve. Prezantimi nga aplikantët zgjat deri në 10 minuta për secilin projekt. Zhvillimi i kësaj faze kryhet kur KMP e sheh të arsyeshme, në konsensus me Kryetarin e Qendrës. Në rast se mbledhja e KMP bëhet on line dhe vendoset që të ketë prezantim të projekteve nga autorët dhe producentët, Qendra organizon takim të përbashkët online, me axhendë të mirëpërcaktuar.

2. Diskutimi i projekteve nga anëtarët e KMP.

Gjatë fazës së diskutimit të projekteve, merr pjesë Kryetari i Qendrës, në rast se ai e sheh të arsyeshme. Anëtarët e KMP-ve, sipas rastit, kërkojnë sqarime për të kuptuar vizionin dhe politikën e Qendrës. Në rast se shihet e nevojshme në këtë fazë mund të marrin pjesë edhe Drejtori i Drejtorisë së Projekteve, apo punonjës të tjerë të Qendrës, për të raportuar rreth çështjeve financiare, juridike, etj. Mbledhja e KMP zhvillohet sipas rastit fizikisht, ose on line.

3. Votimi i projekteve nga anëtarët e KMP.

Procedura e vlerësimit të projekteve nga KMP, (e cila përshkruhet në Kapitullin IV/I).

4. Përzgjedhja e projekteve fitues:

Dokumenti përfundimtar, vendimi i mbledhjes së KMP, përcakton klasifikimin e projekteve dhe masën e financimit të tyre, bazuar mbi ekspertizën financiare të Komsionit Financiar. Në fund vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KMP në gjuhën shqipe dhe angleze.

Kryetari i Qendrës, në varësi të kushteve financiare të institucionit, vendos numrin e projekteve që do të financohen.

KAPITULLI VI

MARRËDHËNIET E QENDRËS ME

PRODUCENTËT/SHTËPITË

KINEMATOGRAFIKE DHE DISTRIBUTORËT

I. RREGJISTRIMI NË QENDËR:

1. Producenti/Shtëpia kinematografike (këtu e më poshtë “Producenti”) duhet të ketë kryer procedurën e regjistrimit, kur fillon marrëdhënie financiare me Qendrën.
2. Producenti dhe distributori regjistrohen në Qendër çdo vit kalendarik.
3. Tarifat e regjistrimit vjetor janë të përcaktuara në aktet nënligjore.
4. Qendra regjistron producentët, ose distributorët për ushtrimin e aktivitetit të tyre, pasi paraqesin on line në platformën e-albania:
 - a. Faturë për kryerjen e pagesës së tarifës së regjistrimit në Qendër.
 - b. Karta e identitetit ose pasaportës së administratorit.
5. Nëpunësi që administron sistemet AMS dhe SQDNE nxjerr nga sistemi edhe ekstraktin e subjektit, ku verifikohet objekti i aktivitetit të tij.
6. Procedura e regjistrimit vjetor kryhet në platformën e-albania, në vaërsi të llojit të shërbimit që kërkohet të ofrohet.
7. Pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm, Qendër pajis producentët dhe distributorët me lejen përkatëse.

II. KONFIRMIMI I PRODUKSIONEVE VENDASE DHE TË HUAJA QË XHIROJNË NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

Për t’u pajisur me leje xhirimi produksionet (vendase apo të huaja) duhet të paraqesin në Qendër dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë për pajisje me leje xhirimi;
2. Sinopsis të projektit filmik;
3. Ekstrakt të kompanisë së Produksionit dhe CV të saj;
4. Informacion për bashkëprodhuesit e projektit filmik (në rast se ka);
5. Përshkrim të lokacioneve ku do të kryhen xhirimet;
6. Plani kalendarik i xhirimeve;
7. Informacion ku të përshkruhen nevojat për mbështetje nga strukturat publike si Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, Autoritetet vendore, etj., për vënien në dispozicion për xhirime të objekteve të ndryshme, rekuizitë, materiale piroteknike, armatim për përdorim skenik, kostume, uniforma, personel, etj.

Nuk do të pajisen me leje projektet filmike që kanë si subjekt:

1. Cënim të të drejtave themelore dhe kushtetuese të njeriut;
2. Cënim të nderit dhe prestigjit të historisë dhe të kombit shqiptar.

3. Kanë përmbajtje apo nxitin ndjenja urrejtje, raciste, terrorizëm, etj.
4. kultivojnë ideologji fundamentaliste, etj.
5. që kanë përmbajtje të thellë pornografike.

III. PARAQITJA E PROJEKTIT PËR KONKURIM:

1. Producentët paraqesin projektet për konkurim në rrugë elektronike, në faqen e internetit www.filmcoproduction.com, që administrohet nga Qendra.
2. Pasi bën regjistrimin vjetor në Qendër, Producenti regjistrohet në këtë faqe dhe hedh të dhënat e tij. Producenti nuk mund të ngarkojë në sistem/aplikojë projekt, pa kryer më parë regjistrimin vjetor në Qendër. Sistemi nuk lejon/pranon kryerjen e veprimeve të mëtejshme.
3. Çdo përdorues i sistemit duhet të regjistrohet nëpërmjet një adrese email të vlefshme. Një përdorues mund të regjistrohet në sistem si industri apo si kineast. Për secilën prej llogarive që do të krijojë në sistem duhet të regjistrohet me adresa emaili të ndryshme. Sistemi nuk e lejon përdorimin e një adrese email-i për dy llogari.
4. Në varësi të llojit të projektit që do të aplikohet, janë të listuara dokumentat e nevojshme (të detyrueshme dhe opsionale), që duhet të ngarkohen për të krijuar dosjen e aplikimit.
5. Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve do të skualifikojë projektet që nuk paraqesin (ngarkojnë në sistem) të gjithë dokumentacionin e përcaktuar "I detyrueshëm", apo që paraqesin (ngarkojnë në sistem) dokumenta të pavlefshëm.
6. Dokumentat që kanë nevojë për nënshkrim do të ngarkohen të skanuara, pasi të jenë nënshkruar / vulosur (sipas rastit).
8. Pas përfundimit të afatit të aplikimeve, Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve, konform procedurës me të cilën operon, vendos për projektet që janë paraqitur (ngarkuar në sistem) në mënyrë korrekte, të cilët do të kalohen për shqyrtim në KMP.
9. Financimet private do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse garantohen nëpërmjet një Deklarate bankare e cila vërteton depozitimin e fondeve në emër të projektit.
10. Projektet që janë paraqitur (ngarkuar në sistem) në mënyrë jo korrekte (me mangësi në dokumentacion), refuzohen nga Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve. Argumentimi përcillet nëpërmjet sistemit dhe Producenti njoftohet me email për arsyet e skualifikimit.
11. Projektet e shpallura fitues nga Këshilli i Miratimit të Projekteve duhet të paraqiten origjinalë pranë Drejtorisë së Projekteve të Qendrës.

IV. RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR APLIKIM:

A- Producenti:

1. Ka të drejtë të paraqesë për konkurim vetëm 1 (një) projekt për çdo kategori konkurimi;
2. Ka të drejtë të paraqesë për konkurim vetëm 1 (një) projekt për film artistik me metrazh të gjatë (pavarësisht nga lloji i tij);
3. Ka të drejtë të paraqesë jo më shumë se 2 (dy) projekte në një sesion konkurimi;
4. Nuk mund të paraqesë projekt për aplikim, në rast se ka 2 (dy) kontrata në proces financimi.
5. Duhet të garantojë se aplikon në Qendër për financim maxhoritar, si dhe që nacionaliteti i filmit të ardhshëm do të jetë Shqiptar.
6. Producentët që nuk kanë realizuar asnjë kontratë me Qendrën, mund të aplikojnë në kategorinë film artistik me metrazh të shkurtër, film artistik dokumentar, apo film të animuar, vetëm pasi të paraqesin kontratë bashkëpunimi me një producent ekzekutiv, i cili, në pozicionin producent, apo producent ekzekutiv ka realizuar të paktën 1 (një) kontratë të suksesshme me Qendrën. Në rast se projekti konkurses shpallet fitues, kontrata e bashkëpunimit ndërmjet tyre do të nënshkruhet para noterit.

B- Regjisori:

1. Ka të drejtë të konkurojë vetëm me 1 (një) projekt në një sezon konkurimi.
2. Nuk ka të drejtë të paraqesë projekt për konkurim pa përfunduar nga ana artistike dhe administrative projektin paraardhës.

C- Producent dhe regjisor

1. Në rastet kur Producenti është edhe Regjisor i projektit kinematografik, atëherë:
 - a. Aplikimi për projektin e radhës do të kryhet vetëm pasi të ketë kaluar 1 (një) vit nga data e premierës zyrtare të veprës së fundit filmike të mbështetur financiarisht nga Qendra.
 - b. Në dokumentat e aplikimit duhet të depozitojë Kontratë me Producentin Ekzekutiv që do të angazhohet në Projekt. Në rast se projekti konkurses shpallet fitues, kontrata e bashkëpunimit ndërmjet tyre do të nënshkruhet para noterit.

D- Të tjera:

1. Do të pranohen në konkurim vetëm projektet që kërkojnë financim maxhor në Qendër dhe që garantojnë paraprakisht se nacionaliteti i filmit të ardhshëm do të jetë shqiptar.
2. Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve, nuk do të kualifikojë në konkurim projekte filmike, që kanë konkuruar dy herë dhe nuk janë shpallur fitues nga KMP.
3. Sesionet e konkurimit për projekte kinematografike hapen si rregull një

herë në vit. Hapja e konkurseve bëhet publike dhe i njoftohet producentëve dhe kineastëve në faqen zyrtare të internetit të Qendrës, www.nationalfilmcenter.gov.al, si dhe në mjetet e tjera të komunikimit elektronik. Afati i aplikimit për konkurset duhet të jenë të paktën 1 muaj.

4. Projektet kinematografike për konkurim, duhet të paraqiten në Qendër vetëm në formë elektronike në faqen www.filmcoproduction.com, përveç projekteve të përshkruara në nënpikën 8/a, të Kapitullit I, të kësaj Rregulloreje.

V. KRITERE TË DETYRUESHME PËR KUALIFIKIM NË KONKURIM:

Krahas rregullave të përgjithshme për aplikim, të përshkruara në nënpikën III (më sipër) për secilin lloj të projektit, duhet të mbahen parasysh edhe kriteret e detyrueshme të mëposhtme:

1. PROJEKTI FILM ARTISTIK ME METRAZH TË GJATË KARRIERE:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.
- b. Producenti duhet të ketë realizuar të paktën dy kontrata financimi të suksesshme me Qendrën, një prej të cilave të jetë film artistik metrazh i gjatë- vepër e parë.
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- d. Regjisori i projektit duhet të ketë realizuar të paktën dy filma, nga të cilët një film me metrazh të gjatë-vepër e parë, me financimin e Qendrës.

2. PROJEKTI FILM ARTISTIK ME METRAZH TË GJATË- VEPËR E PARË:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.
- b. Producenti duhet të ketë realizuar të paktën dy vepra filmike, nga të cilët një vepër filmike të jetë realizuar me financimin e Qendra.
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- d. Regjisori i projektit me metrazh të gjatë - vepër e parë, duhet të ketë realizuar më parë të paktën një film artistik me metrazh të shkurtër të financuar nga Qendra.
- e. Regjisori, i cili nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën d (më sipër) duhet të ketë realizuar të paktën një film artistik me metrazh të gjatë (me fonde të pavarura), që është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kapitulli IV, Seksioni I/E, nënpika 10 të kësaj Rregullore.

3. PROJEKT PËR FILM ARTISTIK ME METRAZH TË SHKURTËR:

- a. Producenti mund të jetë subjekt juridik, ose subjekt fizik shqiptar.
- b. Producenti nuk mund të jetë:
 - i. Skenarist/Bashkëskenarist i projektit;
 - ii. Regjisor/Bashkëregjisor i projektit;
 - iii. I afërm i brezit të parë (bashkëshort/e, fëmijë, motër, vëlla, nënë, babë) me skenarist/bashkëskenarist, regjisor/bashkë-regjisor të projektit.

- c. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- d. Regjisori i projektit duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor për Regji Filmi në një universitet brenda ose jashtë vendit. Të diplomuarit jashtë vendit, duhet të paraqesin diplomën e njehsuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, konform procedurave ligjore në fuqi.
- e. Regjisori, i cili nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën d (më sipër) duhet të ketë realizuar të paktën një film artistik (me fonde të pavarura), që është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kapitulli IV, Seksioni I/E, nënpika 10 të kësaj Rregullore.
- f. Regjisori i projektit duhet të ketë realizuar të paktën 1 (një) film të mëparshëm.

4. PROJEKT PËR FILM DOKUMENTAR:

- a. Producenti mund të jetë subjekt juridik, ose subjekt fizik shqiptar.
- b. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.

5. PROJEKT PËR FILM TË ANIMUAR:

- a. Producenti mund të jetë subjekt juridik, ose subjekt fizik shqiptar.
- b. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.

6. PROJEKTE PËR MINORITY CO-PRODUCTION.

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.
 - b. Producenti shqiptar, duhet të ketë realizuar të paktën një kontratë të suksesshme për film artistik të financuar nga Qendra.
 - c. Producenti duhet të ketë siguruar minimalisht 70% të buxhetit të filmit të parashikuar në kontratën e bashkëprodhimit.
 - d. Projekti të ketë marrë mbështetje financiare prej institucioneve publike nga vendi i origjinës (e vlefshme për vendet e rajonit dhe të Evropës).
 - e. Regjisori duhet të ketë realizuar më parë të paktën një film.
- Deferrals (përfshirë edhe pagesën e producentit dhe overheads) dhe kontributet in-kind, do të pranohen si fonde të konfirmuara deri në një maximum prej 15% të buxhetit total të bashkëprodhimit.

VI. RREGULLA TË VLERËSIMIT TË PROJEKTIT:

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR FINANCIMIN:

1. Producenti mund të nënshkruajë dy kontrata, por nuk mund të financohet për realizimin e dy projekteve në të njëjtën kohë. Përfundim nga ky përcaktim janë:
 - a. Projektete të kategorisë “Projekte të ndryshme”.
 - b. Projekte të kategorisë “Minority Co-production”.
 - c. Financimi i projektit është në interes të Qendrës dhe bëhet me vendim të arsyetuar të Kryetarit.
2. Në rastet kur nënshkruhen dy kontrata financimi (përveç rasteve të përfunduara në pikën 1), financimi i projektit të dytë do të bëhet pasi

Produksioni të ketë mbyllur procesin e justifikimit të dokumentacionit financiar të projektit të parë. Ecuria e projektit të dytë mund të garantohet me fonde të siguruara nga Produksioni në mënyrë alternative, ose me fondet e veta.

3. Projektet për film artistik me metrazh të gjatë vepër karriere, si dhe film artistik me metrazh të gjatë - vepër e parë, janë të detyruar të aplikojnë në Eurimages. Në të kundërt financimi i projektit filmik anulohet.
4. Projektet të cilat përfshihen në një proces gjyqësor (pavarësisht nga gjinia, apo kategoria, apo arsyeja), nuk mund të:
 - a. kualifikohet në konkurim,
 - b. përfitojë financim fillestar,
 - c. përfitojë vazhdim të financimit,
 - d. realizohet mbyllja e projektit.

Nëse rastet e sipërpërmendura, projekti pezullohet deri në vendimmarrje të formës së prerë të gjykatës.

5. Projektet, në të cilët konstatohet se nuk respektohet deklarimi i producentëve për nacionalitetin shqiptar të filmit të ardhshëm, do t'i nënshtrohen vendimmarrjes së KMP lidhur me:
 - a. rishikim të masës së financimit të projektit,
 - b. vazhdimësisë së realizimit të projektit,
 - c. aplikim i masave administrative ndaj producentëve.

VII. NËNSHKRIMI I KONTRATËS:

1. Projekti kinematografik, i cili shpallet fitues me vendim të KMP, do të financohet pasi vendimi i KMP të miratohet nga Kryetari i Qendrës. Në rastet kur Kryetari refuzon të miratojë vendimin e KMP, ky i fundit ka të drejtë të ri-mblidhet dhe të ri-shqyrtojë të njëjtin rend dite. Vendimi që merret në këtë rast është i formës së prerë. Përfundimi i njërës prej këtyre procedurave, konsiderohet si miratim i financimit.
2. Producenti duhet të paraqitet për të nënshkruar kontratën e financimit për projektin e miratuar, jo më vonë se:
 - a. 12 muaj nga data e miratimit të financimit, për projektet e filmit artistik me metrazh të gjatë vepër karriere.
 - b. 9 muaj nga data e miratimit të financimit për projektet për filma artistikë me metrazh të gjatë- vepër e parë, si dhe projektet për bashkëprodhime në minorancë.
 - c. 6 muaj nga data e miratimit të financimit, për projektet film artistik me metrazh të shkurtër, film dokumentar, film i animuar, projektet e ndryshme kinematografike, si dhe projektet për zhvillim projekti.
3. Në raste të veçanta, sidomos kur situata financiare e Qendrës e justifikon një gjë të tillë, afatet e sipërpërmendura mund të ndryshohen me vendim të Kryetarit të Qendrës.
4. Tejkalmi i afateve të sipërpërmendura, (pavarësisht nga arsyet, përfshi edhe pamundësinë e përfundimit të negociatave për nënshkrimin e kontratës), e bën nul vendimin e KMP dhe të Kryetarit për financimin e

- projektit.
5. Producenti, para nënshkrimit të kontratës së financimit me Qendrën, duhet të paraqesë këto dokumenta:
 - a. Preventivin përfundimtar për realizimin e projektit, në përputhje me vlerën e financimit të miratuar nga Qendra.
 - b. Kontratën me autorët kryesorë të filmit/projektit.
 - c. Planin kalendarik i realizimit të projektit.
 - d. Kontratë/a bashkëprodhimi (në varësi të llojit të projektit), ose Deklaratë e Produksionit, në të cilën garantohet mbulimi i zërave që nuk financohen nga Qendra.
 - e. Dokumenta të tjera që vlerësohen se janë të nevojshme në varësi të llojit të projektit, apo janë caktuar nga KMP për t'u paraqitur në këtë fazë.
 6. Producenti duhet të paraqesë këto dokumenta shtesë për filmin artistik me metrazh të gjatë:
 - a. Montazhin financiar/Planin Financiar të projektit, ku paqyrohet financimi i të gjithë bashkëprodhues;
 - b. Raport i periudhës së zhvillimit të projektit.
 7. Para financimit të fazës së xhirimit të filmit, producenti duhet të paraqesë në Qendër:
 - a. Kontratat e nënshkruara me stafin që do të kontribuojë në film, sipas përcaktimeve të bëra në buxhetin e paraqitur të filmit.
 - b. Kontratat e nënshkruara me aktorët kryesorë, rolet e dyta, etj.
 8. Për projekte e kategorisë Minority Coproduction financimi fillestar do të jetë jo më shumë se 20% e fondit të akordur nga Qendra.

VIII. TERMAT KRYESORE TË KONTRATËS:

Kontrata, e cila si rregull hartohet në zbatim të dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në parim, përfshin çështjet e mëposhtme:

- a. afatet e realizimit të projektit.
- b. vlerën dhe periudhat e financimit të projektit nga Qendra.
- c. detyrimin e Produksionit për dorëzimin në Qendër të dokumentave justifikuese për shpenzimet financiare të kryera, të cilat shqyrtohen nga Komisioni Financiar.
- d. detyrimin për depozitim të situacionit përfundimtar të realizimit të projektit, ku shprehet në përqindje kontributi i secilës palë bashkëprodhuese.
- e. sanksionet në rastet e moszbatimit të detyrimeve kontraktore, etj.

IX. TË DREJTA DHE DETYRIME TË TJERA PARA MBYLLJES SË PROJEKTIT:

1. Në përfundim të projektit, para mbylljes së procedurës administrative të projektit filmik, producenti ka detyrim:

- a. Të dorëzojë një kopje të filmit në format DCP/USB në Qendër dhe në AQSHF;
 - b. Të paraqesë në Qendër raport narrativ të realizimit të projektit.
- 2. Premiera e filmit të financuar nga Qendra duhet të plotësojë këto kushte:
 - a. Të kryhet brenda afateve të përcaktuara në kontratën e financimit.
 - b. Në materialet promocionale të vendoset logo e Qendrës, e të shkruhet:
“Me financimin e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”.
 - c. Shfaqja e filmit, detyrimisht duhet të zhvillohet në sallë kinemaje.
- 3. Producenti që ka marrë fond buxhetor në përfundimin e realizimit të veprës, është i detyruar të paraqesë në Qendër:
 - a. raport të hollësishëm për gjithë veprimtarinë e zhvilluar dhe përdorimin e fondit buxhetor;
 - b. deklarimin e të ardhurave për shfrytëzimin e veprave të mëparshme, i cili gjatë vitit të parë të shfrytëzimit bëhet çdo tre muaj, gjatë tre viteve pasardhëse deklarimi bëhet çdo gjashtë muaj, ndërsa për pjesën e mbetur deri në fund të 10 viteve, deklarimi bëhet çdo vit.

KAPITULLI VII

PROJEKTET E BASHKËPRODHIMEVE NË MINORANCË

Projektet e bashkëprodhimeve në minorancë, “Projekte Minority Coproduction”, janë projektet filmike, që realizohen në bashkëprodhim, ku produksioni shqiptar është në minorancë. Si të tilla konsiderohen projektet që garantojnë të paktën njërin nga kriteret e mëposhtme:

a) projekte filmike të autorëve shqiptarë (nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi);

b) projekte filmike të huaja, të cilat plotësojnë, të paktën, njërin nga kriteret e mëposhtme:

– Filmi trajton temë shqiptare;

– Një pjesë e xhirimeve të filmit kryhet në Shqipëri;

– Gjuha origjinale e filmit të jetë gjuha shqipe, në jo më pak se 50% të tij dhe versioni i kopjes përfundimtare të jetë në gjuhën shqipe.

c) projekte filmike të huaja, me interes të veçantë, të cilat shpenzojnë në Shqipëri një masë të konsiderueshme të buxhetit të tyre (nëpërmjet xhirimeve apo proceseve të tjera të prodhimit të filmit).

Rregullat e përgjithshme për financim:

1. Projektet që do të paraqiten për konkurim në këtë kategori, do të financohen në bazë të vlerësimit të ekspertizës financiare të Qendrës, por në çdo rast jo më shumë se 7.000.000 (shtatë milionë) Lekë.
2. Financimi që akordohet nga Qendra për këto projekte, duhet që të shpenzohen në masën jo më pak se 60% të tij, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky financim do të përdoret për përballimin e shpenzimeve të produksionit, apo për angazhimin e stafit dhe/ose aktorëve shqiptarë në projektin filmik.

KAPITULLI VIII

DOKUMENTACIONI I DOSJES SË PROJEKTIT

Dosja e projektit konkurues, (llojet e projekteve të listuara më poshtë), duhet të paraqitet në gjuhën shqipe dhe angleze.

1. PROJEKTI FILM ARTISTIK ME METRAZH TË GJATË (KARRIERE):

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM (duhet të paraqitet në gjuhën shqip dhe anglisht):

1. Kërkesë për financimin e projektit kinematografik.
2. Formulari i aplikimit.
3. Preventivi paraprak i filmit.
4. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta.
5. Synopsis i skenarit – deri në 2 faqe.
6. Lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre (vizual, psikologjik, etj.).
7. Skenari përfundimtar (sipas formatit të programit final draft).
8. Çertifikatë për regjistrimin e skenarit, pranë Drejtorisë së të Drejtës së Autorit- Ministria e Kulturës.
9. Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas/të huaj.
10. Vizioni i regjisorit/Platforma regjisoriale për veprën e ardhshme – deri 3 faqe.
11. C.V. e Producentit.
12. Shënimet e Producentit- deri 2 faqe (Vizioni i producentit për realizimin e projektit, (strategjia e produksionit dhe distribucionit) si dhe bashkëprodhimet ndërkombëtare të realizuara pesë vitet e fundit).
13. Link në vimeo (të shoqëruar me password) të veprës së mëparshme të realizuar nga Produksioni.
14. C.V. e Skenaristit (ku të pasqyrohen edhe karriera, skenarët e xhiruar 5 vitet e fundit).
15. C.V. e regjisorit (ku të pasqyrohen çmimet e rëndësishme ndërkombëtare 5 vitet e fundit).
16. Link në vimeo (të shoqëruar me password) të veprës së mëparshme të regjisorit.
17. Aktmarrëveshje paraprake me autorët kryesorë realizues të projektit.
18. Aktmarrëveshje me Producentin Ekzekutiv që do të angazhohet në realizimin e projektit (në rast se producenti është edhe regjisor).
19. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e Qendrës dhe të ardhurat e realizuara.
20. Link të pjesëmarrjes në festivale filmi të filmave të Regjisorit, si dhe link të çmimeve të fituara (në rast se ka).
21. Deklaratë e shtëpisë kinematografike.
22. Deklaratë për nacionalitetin shqiptar të filmit të ardhshëm.
23. Deklaratë e skenaristit.

Dokumentacion shtesë (jo i detyrueshëm):

- ✓ Informacion për stafin artistik, i cili është element që vlerësohet me pikë.
- ✓ Ilustrime vizuale me fotografi, story board, casting provizor, apo xhirime të thjeshta, që ndihmojnë KMP për perceptuar vizionin dhe stilin e regjisorit.
- ✓ Plani kalendarik i realizimit të projektit.
- ✓ Projekti i distribucionit dhe territoret e shitjes së filmit (kontrata aktmarrëveshje, letra qëllimi nga distributorë të ndryshëm vendas/të huaj).
- ✓ Aktmarrëveshje paraprake me realizuesit dhe interpretuesit kryesorë të veprës.
- ✓ Informacione që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

2. PROJEKTI FILM ARTISTIK ME METRAZH TË GJATË- VEPËR E PARË:

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM (duhet të paraqitet në gjuhën shqip dhe anglisht):

1. Kërkesë për financimin e projektit kinematografik.
2. Formulari i aplikimit.
3. Preventivi paraprak i filmit.
4. Synopsis i skenarit – deri në 2 faqe.
5. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta.
6. Lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre (vizual, psikologjik, etj.).
7. Skenari përfundimtar (sipas formatit të programit final draft).
8. Çertifikatë për rregjistrimin e skenarit, pranë Drejtorisë së të Drejtës së Autorit- Ministria e Kulturës.
9. Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas/të huaj.
10. Vizioni i regjisorit/Platforma regjisoriale për veprën e ardhshme – deri 3 faqe.
11. C.V. e Producentit.
12. Shënimet e Producentit- deri 2 faqe (Vizioni i producentit për realizimin e projektit, (strategjia e produksionit dhe distribucionit) si dhe bashkëprodhimet ndërkombëtare të realizuara pesë vitet e fundit).
13. Link në vimeo (të shoqëruar me password) të veprës së mëparshme të realizuar nga Produksioni.
14. C.V. e Skenaristit (ku të pasqyrohen edhe karriera, skenarët e xhiruar 5 vitet e fundit).
15. C.V. e regjisorit (ku të pasqyrohen çmimet e rëndësishme ndërkombëtare 3 vitet e fundit).
16. Link në vimeo (të shoqëruar me password) me veprën/at e mëparshme të regjisorit
17. Aktmarrëveshje paraprake me autorët e projektit.
18. Aktmarrëveshje me Producentin Ekzekutiv që do të angazhohet në realizimin e projektit (në rast se producenti është edhe regjisor).

19. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e Qendrës dhe të ardhurat e realizuara.
20. Deklaratë për pjesëmarrje në festivale të filmit të mëparshëm, si edhe çmimet e fituara (në rast se ka).
21. Deklaratë e shtëpisë kinematografike.
22. Deklaratë për nacionalitetin shqiptar të filmit të ardhshëm.
23. Deklaratë e skenaristit.

Dokumentacion shtesë (jo i detyrueshëm):

- ✓ Informacion për stafin artistik, i cili është element që vlerësohet me pikë.
- ✓ Ilustrime vizuale me fotografi, story board, casting provizor, apo xhirime të thjeshta, që ndihmojnë KMP për perceptuar vizionin dhe stilin e regjisorit.
- ✓ Plani kalendarik i realizimit të projektit.
- ✓ Projekti i distribucionit dhe territoret e shitjes së filmit (kontrata aktmarrëveshje, letra qëllimi nga distributorë të ndryshëm vendas/të huaj).
- ✓ Aktmarrëveshje paraprake me realizuesit dhe interpretuesit kryesorë të veprës.
- ✓ Informacione që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

3. PROJEKT PËR FILM ARTISTIK ME METRAZH TË SHKURTËR:

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM (duhet të paraqitet në gjuhën shqip dhe anglisht):

1. Kërkesë për shqyrtimin dhe financimin e projektit kinematografik.
2. Formulari i aplikimit.
3. Preventivi paraprak i filmit.
4. Synopsis i skenarit – deri në 1 faqe.
5. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta.
6. Lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre (vizual, psikologjik, etj.).
7. Skenari përfundimtar (sipas versionit të programit Final Draft).
8. Çertifikatë për rregjistrimin e skenarit, pranë Drejtorisë së të Drejtës së Autorit- Ministria e Kulturës.
9. Vizioni i regjisorit/Platforma regjisoriale për veprën e ardhshme – deri në 2 faqe.
10. Shënimet e Producentit- (Vizioni i producentit për realizimin e projektit, (strategjia e produksionit dhe distribucionit).
11. Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas/të huaj.
12. C.V. e Skenaristit.
13. C.V. e Producentit.
14. C.V. e regjisorit.
15. Link të veprës së mëparshme të regjisorit.

16. Aktmarrëveshje paraprake me autorët kryesorë realizues të projektit.
17. Aktmarrëveshje me Producentin Ekzekutiv që do të angazhohet në realizimin e projektit (në rast se producenti është edhe regjisor).
18. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e Qendrës dhe të ardhurat e realizuara.
19. Link të pjesëmarrjes në festivale të filmave të Regjisorit, si edhe çmimet e fituara (në rast se ka).
20. Deklaratë e shtëpisë kinematografike.
21. Deklaratë për nacionalitetin shqiptar të filmit të ardhshëm.
22. Deklaratë e skenaristit.

Dokumentacion shtesë (jo i detyrueshëm):

- ✓ Informacion për stafin artistik, i cili është element që vlerësohet me pikë.
- ✓ Ilustrime vizuale me fotografi/story board, të cilat ndihmojnë KMP për perceptuar vizionin dhe stilin e regjisorit.
- ✓ Plani kalendarik i realizimit të projektit.
- ✓ Projekti i distribucionit dhe territoret e shitjes së filmit – kontrata aktmarreveshje, apo letra qëllimi nga distributorë të ndryshëm vendas, apo të huaj.
- ✓ Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas ose të huaj.
- ✓ Aktmarrëveshje paraprake me realizuesit/interpretuesit e veprës.
- ✓ Informacione/shpjegime që vlerësoni se ndihmojnë prezantimin e projektit.

4. PROJEKT PËR FILM DOKUMENTAR:

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM (duhet të paraqitet në gjuhën shqip dhe anglisht):

1. Kërkesë për shqyrtimin dhe financimin e projektit kinematografik.
2. Formulari i aplikimit.
3. Preventivi paraprak i filmit.
4. Synopsis i skenarit – deri në 1 faqe.
5. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta.
6. Skenari përfundimtar (sipas versionit të programit Final Draft).
7. Çertifikatë për rregjistrimin e skenarit, pranë Drejtorisë së të Drejtës së Autorit- Ministria e Kulturës.
8. Vizioni i regjisorit/Platforma regjisoriale për veprën e ardhshme – deri në 2 faqe.
9. C.V. e Produksionit.
10. C.V. e Regjisorit.
11. C.V. e Skenaristit.
12. Shënimet e Producentit- (Vizioni i producentit për realizimin e projektit, (strategjia e produksionit dhe distribucionit).

13. Link me vepër të mëparshme të regjisorit.
14. Aktmarrëveshje paraprake me autorët e projektit.
15. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e Qendrës dhe të ardhurat e realizuara.
16. Deklaratë e shtëpisë kinematografike.
17. Deklaratë për nacionalitetin shqiptar të filmit të ardhshëm.
18. Deklaratë e skenaristit.

Dokumentacion shtesë (jo i detyrueshëm):

- ✓ Informacion për grupin realizues, i cili është element që vlerësohet me pikë.
- ✓ Plani kalendarik i realizimit të projektit.
- ✓ Projekti i distribucionit dhe territoret e shitjes së filmit (kontrata aktmarreveshje, apo letra qëllimi nga distributorë të ndryshëm vendas, apo të huaj).
- ✓ Deklaratë për pjesëmarrje në festivale të filmit të mëparshëm, si edhe çmimet e fituara (në rast se ka).
- ✓ Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas dhe/ose të huaj.
- ✓ Aktmarrëveshje apo kontrata paraprake me realizuesit dhe interpretuesit kryesorë të veprës.
- ✓ Informacione apo shpjegime që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

5. PROJEKT PËR FILM TË ANIMUAR:

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM (duhet të paraqitet në gjuhën shqip dhe anglisht):

1. Kërkesë për shqyrtimin dhe financimin e projektit kinematografik.
2. Formulari i aplikimit.
3. Preventivi paraprak i filmit.
4. Synopsis i skenarit – jo më shumë se 1 faqe.
5. Skenari përfundimtar.
6. Çertifikatë për rregjistrimin e skenarit, pranë Drejtorisë së të Drejtës së Autorit- Ministria e Kulturës.
7. Personazhet dhe dekoret. Materializimi i personazheve dhe dekoreve në teknikën dhe formatin me të cilën do të realizohet filmi. (vizatim, kolazh, kukulla, plasteline, 3D etj).
8. Story-board.
9. Vizioni i regjisorit për veprën e ardhshme.
10. Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas/të huaj.
11. C.V. e Skenaristit, (të ketë informacion për Çmimet ndërkombëtare 3 vitet e fundit; skenarët e xhiruar).

12. C.V. e Producentit.
13. C.V. e Regjisorit, (të ketë informacion për Çmimet ndërkombëtare 3 vitet e fundit).
14. Shënimet e Producentit- (Vizioni i producentit për realizimin e projektit, (strategjia e prodhimit dhe distribucionit).
15. Link me punë të mëparshme të regjisorit.
16. Aktmarrëveshje paraprake me autorët e projektit.
17. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e Qendrës dhe të ardhurat e realizuara.
18. Deklaratë për pjesëmarrje në festivale të filmit të mëparshëm, si edhe çmimet e fituara (në rast se ka).
19. Deklaratë e shtëpisë kinematografike.
20. Deklaratë për nacionalitetin shqiptar të filmit të ardhshëm.
21. Deklaratë e skenaristit.

Dokumentacion shtesë (jo i detyrueshëm):

- ✓ Informacion për grupin realizues, i cili është element që vlerësohet me pikë.
- ✓ Material pilot 10 - 30 sekonda, i cili do të shërbejë për të krijuar një ide më të qartë rreth qasjes artistike dhe estetike, atmosferës, animacionit, teknikës dhe formatit me të cilin do të realizohet filmi
- ✓ Plani kalendarik i realizimit të projektit.
- ✓ Projekti i distribucionit dhe territoret e shitjes së filmit (kontrata aktmarrëveshje, apo letra qëllimi nga distributorë të ndryshëm vendas, apo të huaj).
- ✓ Informacione apo shpjegime që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

6. PROJEKT PËR FESTIVAL FILMI (kombëtar dhe ndërkombëtar):

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM (duhet të paraqitet në gjuhën shqip dhe anglisht):

1. Kërkesë për shqyrtimin dhe financimin e projektit kinematografik.
2. Formulari i aplikimit.
3. Preventivi paraprak i projektit.
4. Plani kalendarik.
5. Aktmarrëveshje paraprake me partnerë të realizimit të aktivitetit, vendas/të huaj.
6. C.V. e shtëpisë kinematografike.
7. C.V. e aplikantit.
8. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për të ardhurat e realizuara nga projekte të mëparshme të prodhuar me financimin e Qendrës.
9. Deklaratë e shtëpisë kinematografike.

Dokumentacion shtesë (jo i detyrueshëm):

- ✓ Informacion për grupin realizues, i cili është element që vlerësohet me pikë.
- ✓ Informacione apo shpjegime që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

7. PROJEKTE TË NDRYSHME KINEMATOGRAFIKE:

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM (duhet të paraqitet në gjuhën shqip dhe anglisht):

1. Kërkesë për shqyrtimin dhe financimin e projektit kinematografik.
2. Formulari i aplikimit.
3. Preventivi paraprak i projektit.
4. Plani kalendarik.
5. Aktmarrëveshje paraprake me partnerë të realizimit të aktivitetit, vendas/të huaj.
6. C.V. e shtëpisë kinematografike.
7. C.V. e aplikantit.
8. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për të ardhurat e realizuara nga projekte të mëparshëm të prodhuar me financimin e Qendrës.
9. Deklaratë e shtëpisë kinematografike.

Dokumentacion shtesë (jo i detyrueshëm):

- ✓ Informacion për grupin realizues, i cili është element që vlerësohet me pikë.
- ✓ Informacione apo shpjegime që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

8. PROJEKTE PËR ZHVILLIM PËR FILMA ARTISTIKË.

Me “Zhvillim projekti”, kuptohet ndjekja, frekuentimi i forumeve, lab-eve, workshop-eve, etj., të organizuara nga institucione publike, apo të pavarura, të cilat janë të njohura zyrtarisht në nivel ndërkombëtar dhe konsistojnë në:

1. Zhvillim skenari;
2. Zhvillim produksioni, e cila nënkupton sigurim bashkëprodhimi real vendas ose të huaj, me financime publike, ose private.

Financimet private do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse garantohen nëpërmjet një Deklarate bankare e cila vërteton depozitimin e fondeve në emër të projektit.

Kritere të detyrueshme për kualifikim në konkurim në këtë kategori konkurimi, do të jenë kriteret e detyrueshme të kategorisë përkatëse ku kualifikohet vepra e ardhshme kinematografike.

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM (duhet të paraqitet në gjuhën shqip dhe anglisht):

1. Kërkesë për financimin e projektit kinematografik.
2. Formulari i aplikimit.
3. Preventivi paraprak i zhvillimit të projektit.
4. Treatment (jo më pak se 10 faqe) / skenar.
5. Synopsis i shkurtër (5 rreshta).
6. Synopsis i gjatë (deri 2 faqe).
7. Lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre (vizual, psikologjik, etj.).
8. C.V. e Producentit, (ku të pasqyrohet filmat e prodhuar).
9. Shënimet e Producentit- deri 2 faqe (Vizioni i producentit për realizimin e projektit, (strategjia e produksionit dhe distribucionit) si dhe bashkëprodhimet ndërkombëtare të realizuara pesë vitet e fundit).
10. C.V. e Skenaristit (ku të pasqyrohen edhe karriera, skenarët e xhiruar 5 vitet e fundit).
11. C.V. e regjisorit (ku të pasqyrohen edukimi kinematografik i regjisorit).
12. Aktmarrëveshje paraprake me autorët realizues të projektit.
13. Raport mbi qarkullimin, promovimin, dhe rezultatet e tjera të veprës së mëparshme të regjisorit.
14. Raport mbi qarkullimin, promovimin, dhe rezultatet e tjera të veprës së mëparshme të producentit.
15. Link në vimeo (të shoqëruar me password) të veprës së mëparshme të realizuar nga Produksioni.
16. Link në vimeo (të shoqëruar me password) të veprës së mëparshme të regjisorit.
17. Listë të pjesëmarrjes në festivale të filmave të mëparshëm të Regjisorit, si dhe listë të të çmimeve të fituara (në rast se ka).
18. Deklarata e Producentit për distribucionin e veprave filmike të mëparshme.
19. Deklaratë e shtëpisë kinematografike.
20. Deklaratë e skenaristit.

Dokumentacion shtesë (jo i detyrueshëm):

- ✓ Plani kalendarik i realizimit të projektit.
- ✓ Aktmarrëveshje apo kontrata paraprake me bashkëproducentë (vendas apo të huaj).
- ✓ Aktmarrëveshje apo kontrata paraprake me interpretuesit kryesorë të veprës.
- ✓ Informacione apo shpjegime që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

9. PROJEKTE PËR MINORITY CO-PRODUCTION.

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM (duhet të paraqitet në qjuhën shqip dhe anglisht):

1. Kërkesë për financimin e projektit kinematografik.
2. Formulari i aplikimit.
3. Plan buxheti i filmit, nënshkruar nga të gjithë bashkëprodhuesit, ku të jetë përcaktuar pjesa e buxhetit që do të shpenzohet në Shqipëri.
4. Skenari përfundimtar, (në formatin Final Draft).
5. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta.
6. Lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre (vizual, psikologjik, etj.).
7. Synopsis i skenarit – deri në 2 faqe.
8. Vizioni i regjisorit/Platforma regjisoriale për veprën e ardhshme.
9. Link në Vimeo (shoqëruar me password-in) të veprës së mëparshme të Regjisorit.
10. Përshkrim për ecurinë e filmit të mëparshëm të regjisorit.
11. Kontrata e bashkëprodhimit, e nënshkruar nga të gjithë bashkëprodhuesit, shoqëruar me buxhetin e filmit, në të cilin të përcaktohen përqindjet e pjesëmarrjes për secilin bashkëprodhues.
12. Plan i financiar i projektit, ku të jenë specifikuar të gjitha burimet e konfirmuara dhe të prithsme për të përfituar mbështetje financiare.
13. Konfirmim/vërtetim/dëshmi (original ose fotokopje e noterizuar), që vërteton se produksioni ka siguruar mbështetje nga fonde publike.
14. Përshkrim i vendeve ku do të realizohen xhirimet e filmit, ku të mirëpërcaktohet kohëzgjatja e xhirimeve në territorin shqiptar.
15. Kontrata e produksionit maxhoritar për blerjen e të drejtave të skenarit.
16. Kontrata e produksionit maxhoritar me regjisorin.
17. C.V. e shtëpisë kinematografike.
18. C.V. e regjisorit.
19. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e Qendrës.
20. Deklaratë e shtëpisë kinematografike.
21. Plan i kalendarik i realizimit të projektit.

Dokumentacion shtesë (jo i detyrueshëm):

- ✓ Ilustrime vizuale me fotografi, story board, casting provizor, apo xhirime të thjeshta, që ndihmojnë KMP për perceptuar vizionin dhe stilin e regjisorit.
- ✓ Projekti distribicioni dhe territoret e shitjes së filmit (kontrata aktmarrëveshje, nga distributorë të ndryshëm vendas/të huaj).
- ✓ Informacione që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

KAPITULLI IX

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.

2. Bashkëlidhur kësaj Rregullore miratohen edhe Anekset përfaktëse.

3. Me hyrjen në fuqi, të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë nr. 155 Prot., datë 24.04.2020, si dhe amendimet përkatëse.

ANEKSI 1

FORMULAR APLIKIMI PËR PROJEKTE:

1. Film artistik metrazh i gjatë
2. Film artistik metrazh i gjatë- vepër e pare dhe e dytë
3. Film artistik metrazh i shkurtër
4. Film dokumentar
5. Film i animuar



REPUBLIKA E SHQIPERISE
QENDRA KOMBETARE E KINEMATOGRAFISE

FORMULAR APLIKIMI

PËR PROJEKT FILMIK

Titulli “ _____ ”

I. LLOJI I PROJEKTIT:

(Zgjidh kategorinë ku do të aplikosh)

☐	☐	☐	☐	☐
Film artistik Vepër karriere	Film artistik Vepër e I & II	Film i shkurtër	Film dokumentar	Film i animuar

II. TË DHËNAT E PROJEKTIT:

1	Titulli i Projektit	
2	Skenaristi/e	
3	Regjisori/e	
4	Kompozitori/e	
5	Drejtori/e e Fotografisë	
6	Shtëpia kinematografike /Producenti/e	
7	E-mail/tel:	

III. KATEGORIA:

☐	Romancë	☐	Historik	☐	Fantastik	☐	Triller
☐	Aksion	☐	Komedi	☐	Dramë	☐	Tjetër

IV. TË DHËNA TEKNIKE:

1	Kamera	☐	2K	☐	4K	☐	8K	☐	Tjetër
2	Sound	☐	Dolby SR-D	☐	DTS Digital Theater Systems	☐	SDDS Sony Dynamic Digital Sound	☐	Tjetër

V. TË DHËNA TË TJERA:

1	Gjuha origjinale	☐	Shqip	☐	Tjetër
2	Vendxhirimet	☐	Shqipëri	☐	Tjetër
3	Kohëzgjatja	_____ minuta			
4	Kombësia e filmit (shqiptar)	☐	Po	☐	Jo

VI. TË DHËNA FINANCIARE PARAPRAKE:

1	Buxheti paraprak (total)	_____ Lek
2	Buxheti kërkuar nga QKK	_____ Lek
3	Buxheti shqiptar (siguruar)	☐ Publik _____ Lek
		☐ Të tjera _____ Lek
4	Buxheti i huaj (siguruar)	☐ Publik _____ Lek
		☐ Të tjera _____ Lek

VII. TË DHËNA PËR FAZËN E ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT:

1. Skenari ka kaluar fazën e zhvillimit.

☐ Po ☐ Jo

Nëse po, ku është zhvilluar ?

(ju miund të selektoni më shumë se një kuadrat).

- ☐ Creative Europe program media (link i vendimit)
- ☐ Script Doctor (dokumenta mbështetëse)
- ☐ Workshop për zhvillim skenari (emri, vendi, data)
- ☐ Workshop për zhvilim të projektit filmik (emri, vendi, data)
- ☐ Pitching (eventi, vendi, data)
- ☐ Të tjera

2. Skenari ose projekti filmik janë vlerësuar me çmim në fazën e zhvillimit.

☐ Po ☐ Jo

Nëse po, ku? _____

3. Skenari ose projekti filmik kanë përfituar mbështetje financiare në fazën e zhvillimit.

☐ Po ☐ Jo

Nëse po: vendi, data, shuma? _____

Shënim: Të gjitha të dhënat e deklaruara më sipër për zhvillimin e projektit, duhet të shoqërohen me dokumentacionin përkatës dhe të jenë pjesë e dosjes së aplikimit.

Për shtëpinë kinematografike

(emër, mbiemër, firma, vula)

Tiranë, _____. _____. 202____

Shënim: Formulari do të ngarkohet në sistem i skanuar (i nënshkruar dhe i vulosur).



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË**

FORMULAR APLIKIMI

**PËR ZHVILLIM TË PROJEKTIT
FILMIK**

Titulli “_____”

I. TË DHËNA TË PROJEKTIT:

1	Titulli	
2	Shtëpia kinematografike / Producenti / e	
3	E-mail / Tel:	

II. AUTORËT:

1	Skenaristi / e	
2	Regjisori / e	

III. KATEGORIA:

☐	Romancë	☐	Historik	☐	Fantastik	☐	Triller
☐	Aksion	☐	Komedi	☐	Dramë	☐	Tjetër

IV. TË DHËNA TË TJERA:

1	Gjuha origjinale	Shqiptar	Tjetër
2	Kohëzgjatja	_____ minuta	

V. TË DHËNA FINANCIARE:

1	Buxheti paraprak (total)	_____ Lek
2	Buxheti që kërkohet nga QKK	_____ Lek
3	Buxheti shqiptar (siguruar)	☐ Publike _____ Lek
		☐ Të tjera _____ Lek
4	Buxheti i huaj (siguruar)	☐ Publike _____ Lek
		☐ Të tjera _____ Lek

Për shtëpinë kinematografike

(emër, mbiemër, firma, vula)

Tiranë, ____ . ____ . 202__

Shënim: Formulari do të ngarkohet në sistem i skanuar (i nënshkruar dhe i vulosur).

ANEKSI 3

**FORMULAR APLIKIMI PËR PROJEKTE TË NDRYSHME
KINEMATOGRAFIKE FESTIVAL FILMI (brenda dhe jashtë vendit)**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË**

FORMULAR APLIKIMI

Projekt Kinematografik

Lloji i projektit- FESTIVAL FILMI

(TITULLI)- “ _____ ”

I. TË DHËNAT KRYESORE TË PROJEKTIT:

1	Titulli i projektit	
2	Shtëpia kinematografike	
3	Adresa	
4	Tel & Fax	
5	Website/ E- mail	

**II. AUTORËT DHE REALIZUESIT KRYESORË:
(plotëso sipas llojit të projektit)**

1		
2		
3		

III. LLOJI I PROJEKTIT:

Festival filmi kombëtar	Festival filmi ndërkombëtar
-------------------------	-----------------------------

IV. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT:

--

V. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTIT:

--

VI. PRITSHMËRITË E PROJEKTIT:**NË KËTË SEKSION DUHET TË JEPNI TË DHËNA PËR:**

- Audienca e pritshme në Festival (e shprehur në shifra):
- Numri i filmave të huaj/ shqiptarë që parashikohet të aplikojnë:
- Numri i filmave të huaj/ shqiptarë që parashikohet të seleksionohen në konkurim:

- Partnerët që parashikohet se do të mbështesin Festivalin (të konfirmuar dhe ata që priten):
- Kineastë dhe personalitete të huaj që do të marrin pjesë në Festival (të konfirmuar dhe në pritshmëri):
- Aktivitetet që do të organizohen në kuadrin e Festivalit (workshop, trajnime, promovime, etj.)

VII. TË DHËNA FINANCIARE PARAPRAKE

1	Vlerësimi i producentit për buxhetin e realizimit të projektit	
2	Financime shqiptare (të siguruara)	
3	Financime të huaja (të siguruara)	

Tiranë, më ____ . ____ . 202__

Për shtëpinë kinematografike

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

Shënim:

Formulari do të ngarkohet në sistem i skanuar (i nënshkruar dhe vulosur).

ANEKSI 4

**FORMULAR APLIKIMI PËR PROJEKTE TË NDRYSHME
KINEMATOGRAFIKE**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË**

FORMULAR APLIKIMI

Projekt Kinematografik

Lloji i projektit- _____

(TITULLI)- “ _____ **”**

I. TË DHËNAT KRYESORE TË PROJEKTIT:

1	Titulli i projektit	
2	Shtëpia kinematografike	
3	Adresa	
4	Tel & Fax	
5	Website/ E- mail	

II. AUTORËT / REALIZUESIT KRYESORË: (plotëso sipas llojit të projektit)

1		
2		

LLOJI I PROJEKTIT:

☐ Javë filmi Kombëtare	☐ Botime (kinematografike)	☐ Workshop
☐ Javë filmi Ndërkombëtare	☐ Seminar	☐ Aktivitet tjetër kinematografik

III. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT:**IV. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTIT:****V. PRITSHMËRITË E PROJEKTIT:**

NË KËTË SEKSION DUHET TË PARAQESNI TË DHËNA PËR PRITSHMËRITË E PROJEKTIT (Javë filmi kombëtare dhe ndërkombëtare) lidhur me:

- Audiencia e pritshme:
- Numri i filmave që do të shfaqen:
- Partnerët që parashikohet se do të mbështesin aktivitetin (të konfirmuar dhe ata që priten):
- Informacione të tjera të vlefshme që mendoni se prezantojnë sa më mirë projektin.

VI. Të dhëna financiare paraprake

1	Vlerësimi i producentit për buxhetin e realizimit të projektit	
2	Financime shqiptare (të siguruara)	
3	Financime të huaja (të siguruara)	

Tiranë, më ____ . ____ . 202__

Për shtëpinë kinematografike

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

Shënim: Formulari do të ngarkohet në sistem i skanuar (i nënshkruar dhe vulosur).

ANEKSI 5

**FORMULAR APLIKIMI PËR PROJEKT BASHKËPRODHIMI NË
MINORANCË (minority co-production)**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË**

FORMULAR APLIKIMI

Projekt kinematografik për film

**Kategoria MINORITY
COPRODUCTION**

Titulli provizor “_____”

I. LLOJI I PROJEKTIT:

Shënoni brenda kuadtratit gjininë në të cilën do të aplikoni

☐ Film artistik metrazh i gjatë	☐ Film artistik metrazh i shkurtër	☐ Film dokumentar	☐ Film i animuar
--	---	--	---

II. AUTORËT KRYESORË TË PROJEKTIT:

1	Titulli i projektit	
2	Skenaristi	
3	Regjisori	
4	Kompozitori	
5	Drejtori i Fotografisë	

III. TË DHËNAT E PRODUKSIONIT:

1.	Shtëpia kinematografike APLIKUESE	
1.1	Administratori/Producenti	
1.2	Adresa / Kontakt	
2.	Bashkëprodhuesi maxhoritar Shteti	
2.1	Administratori/Producenti	
2.2	Adresa / Kontakt	
3.	Bashkëprodhues të tjerë Shteti (nëse ka)	
3.1	Administratori/Producenti	
3.2	Adresa / Kontakt	

IV. BUXHETI I PROJEKTIT:

Nr	Buxheti i projektit filmik	Euro	Lekë	Fond Publik %	Fond tjetër %
1.	Buxheti Total i filmit				
2.	Buxheti i bashkëprodhuesit maxhoritar				
3.	Buxheti i bashkëprodhuesit/ëve				
4.	Buxheti i kërkuar nga QKK				

V. ZHANRI I PROJEKTIT:

☐ Romancë	☐ Historik	☐ Fantastik	☐ Triller
☐ Aksion	☐ Komedi	☐ Dramë	☐ Tjetër

VI. TË DHËNA TEKNIKE:

1	Formati i xhirimit				
	Elektronikë	☐ 2K	☐ 4K	☐ 8K	☐ Tjetër
	Pelikul	☐ 35 mm	☐ Super 16 mm	☐ Tjetër	

2	Formati i zërit			
	☐ SR-D Dolby	☐ DTS Digital Theater Systems	☐ SDDS Sony Dynamic Digital Sound	☐ Tjetër

VII. TË DHËNA TË TJERA:

1	Gjuha origjinale e filmit	Shqip	Shqip / E huaj
2	Vendet e xhirimit	Shqipëri ____%	Jashtë vendit ____%
3	Kohëzgjatja e filmit	_____ minuta	

Tiranë, më ____ . ____ . 202__

Për shtëpinë kinematografike

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

Shënim:

Formulari do të ngarkohet në sistem i skanuar (i nënshkruar dhe vulosur).

ANEKSI 6

DEKLARIM I PRODUCENTIT/SHTËPISË KINEMATOGRAFIKE

Unë që nënshkruaj _____, mbajtës i dokumentit të identifikimit _____, në cilësinë e përfaqësuesit të shtëpisë kinematografike _____, me përgjegjësi ligjore

DEKLAROJ:

Paraqes në konkurim për mbështetje financiare projektin kinematografik me titull: _____.

Pasi u njoha me gjithë dokumentacionin, kushtet ligjore, detyrimet reciproke etj, deklaroj pranimin, plotësimin dhe respektimin e tyre si dhe njohjen e autoritetit të QKK-së për shqyrtimin e dokumentacionit në procedurat e konkurimit.

Deklaroj se:

1. Në dosjen time kam dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga QKK. Në se evidentohet nga sistemi se nuk janë ngarkuar të gjitha dokumentat e detyrueshme, apo njëri prej tyre nuk i plotë, jam i informuar se mund të eliminohem nga konkurimi.
2. Nuk kam konflikt interesi me anëtarët e Këshillit të Miratimit të Projekteve, apo personat vendimmarrës në QKK.
3. Pranoj si të padiskutueshëm rezultatin e vendimmarrjes së KMP, në rast se projekti nuk kualifikohet për financim.
4. Jam në dijeni që çdo ndryshim, tjetërsim, apo zëvendësim i komponentëve financiar, ekonomik, teknik dhe artistik, që janë dorëzuar në dokumentacionin për aplikim, të cilat influencojnë vendimmarrjen e KMP, autorizojnë QKK të refuzojë nënshkrimin e kontratës, nëse nuk e konsideron realizueshmërinë e projektit brenda të gjitha standarteve teknike dhe profesionale.

Për shtëpinë kinematografike

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

Tiranë, më _____. _____. 202__

Shënim:

Deklarata do të ngarkohet në sistem e skanuar (e nënshkruar dhe vulosur).

ANEKSI 7

DEKLARIMI I SKENARISTIT

Unë që nënshkruaj, _____, mbajtës i dokumentit të identifikimit _____, nën përgjegjësi ligjore

DEKLAROJ:

1. Skenari me titull “_____” është shkruar prej meje dhe është original/regjistruar në Zyrën Shqiptare të Drejtës së Autorit.

2. Skenari me titull “_____” është i mbështetur në motivet e veprës “_____”, të autorit z. _____.
/veprës “_____”, të autorit z. _____.
Për përdorimin e sa më sipër, kam blerë të drejtën/kam marrë pëlqimin me shkrim nga autori.

3. Skenarin me titull “_____” ia jap për shfrytëzim (në këtë sesion konkurimi) Shtëpisë kinematografike _____, për konkurim për mbështetje financiare në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë.

Tiranë, më _____. _____. 202__

Skenaristi:

Emri Mbiemri

Nënshkrimi

Shënime:

1. Nëse skenari është original duhet të plotësohen pikat 1 dhe 3;
2. Nëse skenari është i bazuar në veprën e ndonjë autori tjetër, duhet të plotësohen pikat 2 dhe 3 dhe të bashkëngjitet pëlqimi me shkrim i autorit.
3. Deklarata do të ngarkohet në sistem e skanuar (e nënshkruar).

ANEKSI 8

DEKLARATË

Ne që nënshkruajmë:

1. Z. _____, mbajtës i dokumentit të identifikimit _____, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shtëpisë kinematografike _____,

2. Z. _____, mbajtës i dokumentit të identifikimit _____, në cilësinë e regjisorit të projektit kinematografik, me përgjegjësi të plotë ligjore deklarojmë sa më poshtë:

1. Paraqesim në konkurim për mbështetje financiare projektin kinematografik me titull “_____”, për të cilin kërkojmë mbështetje financiare maxhoritare. Në këtë mënyrë pranojmë dhe njohim deri në përfundim të këtij projekti se financimi i QKK do të jetë financimi maxhoritar (në rast se projekti shpallet fitues).

2. Nacionaliteti i filmit që do të prodhojmë, (në rast se projekti shpallet fitues), do të jetë shqiptar.

Për shtëpinë kinematografike

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

Regjisor

(emri, mbiemri)

Tiranë, më ____ . ____ . 202_

Shënim:

Deklarata do të ngarkohet në sistem e skanuar (e nënshkruar dhe vulosur).